

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**-Departamenti i Përgjithshëm, më Gjyqtaren Ilirjana Hoti, si dhe me zyrarin ligjor Getoar Ademi, në lëndën penale kundër të akuzuarit M. R. nga fshati S., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 186 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti-Përgjithshëm, në Gjakovë, PP.nr.191/17 të dt.15.03.2017, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me dt.**09.06.2017**, murr këtë:

## A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e PTH-DP ne Gjakovë PP.nr.191/2017 e dt.15.03.2017, dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

## URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

**M. R.**, i biri i L. e ëma Gj. e gjinisë Rr., data e lindjes..., në Gjakovë, tani me banim në fshatin S., Komuna e Gjakovës, me nr. personal..., ka të kryer shkollën e mesme, i divorcuar, me profesion automekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

## Ë s h t ë f a j t o r

**Sepse :**

Me dt.19.01.2017, rreth orës 16:00, përfshihet me sjellje të vëmendjes se vazhdueshme dhe të padëshirueshme, me qëllim të ngacmimit, lëndimit, frikësimit të personit tjetër ashtu që ditën kritike përmes rrjetit social Facebook ka publikuar fotografitë e ish bashkëshortes së tij – përkatësisht të dëmtuarës B. N. nga Gjakova, me një person tjetër ku ka shkruar “këta janë dy të dashuruarit, njëri i ka 4 fëmijë ndërsa tjetri 5 fëmijë”, fotografi të cilën e kishte modifikuar në kompjuter si dhe në vazhdimësi duke shkuar tek banesa e saj edhe pse të ndarë prej kohësh, duke i thënë fjalë të ndryshme fyese, për cka tek e njëjta ka shkaktuar shqetësim emocional të madh.

**-me çka ka kryer veprën penale ngacmimi nga neni 186 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata konform nenit 4, 41, 43, 46, 73, dhe nenit 186 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 495 të KPPK-së, të akuzuarin Marjan Radi, e

## G J Y K O N

Dënimin me gjobë në shumë prej **200.00 € (dyqind euro)**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë, së këtij Aktgjykimi - Urdhër ndëshkimor, në kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 39 të KPK-së, atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej **10 (dhjetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20 (njëzet) euro**.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga **30,00 €**, e këtë në afat prej **15 ditësh** pasi që Aktgjykimi-urdhri ndëshkimor të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

## A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore - Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP.nr.191/17 të dt.15.03.2017, ndaj të akuzuarit M. R. nga fshati S., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 186 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 493 të KPPK-së, PTH në Gjakovë, kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarit të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënimi me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës së nenit 186 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, e cila dispozitë për kryesit e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim deri në 3 (tre) vite.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 495 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-së dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH –se në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit .

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndes siç janë:

- kallëzimi penal me nr.2017-EA-0083 të dt.16.02.2017,
- deklarata e të akuzuarit të dhënë në Polici me dt.16.02.2017,
- deklarata e të dëmtuarës të dhënë në Polici me dt.20.01.2017,
- raporti i hetuesit A. H. të dt.20.01.2017,
- raporti fillestar i incidentit me nr. rasti 2017-EA-0083 të dt.20.01.2017,
- foto-dokumentacioni, si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë,

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPRK-së, në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr konform nenit 450 par.2 dhe 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË** **P.nr.199/17 të dt.09.06.2017**

**Zyrtari Ligjor,**  
**Getoar Ademi**

**Gjyqtarja**  
**Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjyqtarës të kësaj Gjykate. Nëse i pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.